



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1146/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI140/16

Parashtrues

Raiffeisen Bank Kosovo JSC

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 6/2016, të 23 gushtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Raiffeisen Bank Kosovo JSC (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ilir Tahiri, përfaqësuesi i tij juridik.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 6/2016, të 23 gushtit 2016, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 20 shtator 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI140/16, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI140/16, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 31 janar 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 27 mars 2017, Gjykata informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme të dorëzojë kopjen e fletëdorëzimit, me të cilën parashtruesi është njoftuar për kërkesën e palës kundërshtare për kthim në gjendje të mëparshme.
9. Më 7 prill 2017, Gjykata Supreme bashkëngjiti shkresat e lëndës të kompletuara përfshirë dhe fletëdorëzimin me të cilin kishte njoftuar parashtruesin për kërkesën e palës kundërshtare, të pranuar më 14 janar 2016.
10. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI10/14, të 26 qershorit 2014

11. Në vitin 2002, parashtruesi i kërkesës kishte shkarkuar një punonjës. Ai punonjës kishte filluar procedurat gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkarkimin e tij në të gjitha instancat e gjyqësorit të rregullt.
12. Më 21 janar 2013, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e punonjësit për revizion si të paafatshme.
13. Pas kësaj, punonjësi parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për kthim në gjendje të mëparshme të vendimmarrjes lidhur me revizionin.
14. Më 19 tetor 2013, me Aktgjykimin C. nr. 7/2013, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën e punonjësit për kthim në gjendje të mëparshme.
15. Më 28 janar 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë, duke pretenduar se Gjykata Supreme kishte vendosur për kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, pa e njoftuar parashtruesin e kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte qenë në gjendje të paraqesë argumentet e tij ligjore lidhur me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme. Kjo kërkesë ishte regjistruar nën numrin KI10/14.
16. Më 20 maj 2014, Gjykata nxori aktgjykimin e saj, duke konstatuar se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata e ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, C. nr. 7/2013 të 19 tetorit 2013 dhe e ktheu çështjen përsëri në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI10/14

17. Më 22 mars 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 85/2016 e përsëriti procedurën sipas kërkesës së punonjësit, e lejoi kërkesën e punonjësit për kthim në gjendjen e mëparshme dhe shfuqizoi Aktvendimin [Rev. nr. 333/2011] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 21 janarit 2013.
18. Më 27 prill 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme në Gjykatën Supreme. Më 23 gusht 2016, me Aktvendimin CN. nr. 6/2016, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të paafatshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:
 - (i) Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Rev. nr. 85/2016] nuk e kishte respektuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI10/14, të 26 qershorit 2014, sepse me rastin e marrjes së këtij

Aktgjykimi nuk ia kishte dorëzuar paraprakisht parashtruesit kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe nuk e kishte ftuar parashtruesin e kërkesës t'i paraqesë argumentet e tij, dhe kështu është shkelur seriozisht neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], dhe

(ii) Gjykata Supreme me Aktvendimin [CN. nr. 6/2016] gjithashtu e kishte shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke e hedhur poshtë, si të paafatshëm, propozimin e tij për kthim në gjendje të mëparshme, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 85/2016, sepse sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ai nuk ka qenë i njoftuar për kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe kështu nuk i është ofruar mundësia për të paraqitur rastin e tij, me ç'rast seriozisht janë cenuar neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

20. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

- I. *“Të shpallë kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës të pranueshme;*
- II. *Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 (1) [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;*
- III. *Të konstatojë se ka pasur shkelje të Nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;*
- IV. *Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës REV. nr. 85/2016, të datës 22 mars 2016 dhe Aktvendimin CN. nr. 6/2016 të datës 23 gusht 2016 dhe të kthejë lëndën për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese;*
- V. *Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë.”*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

23. Në vazhdim, Gjykata i referohet edhe nenit 21.4 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

24. Gjkata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*Neni 48
Saktësimi i kërkesës*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

25. Gjkata në vazhdim merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat procedurale të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të verifikuar pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e parapara në nenin 48 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme mohoi (i) të drejtën për efekt ligjor të vendimit dhe, rrjedhimisht, (ii) të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 116 të Kushtetutës

28. Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

29. Për sa i përket pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se pretendimet ankimore në lidhje me shkeljen e të drejtave kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën Gjykata Supreme e zbatoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI10/14, të 20 majit 2014.

30. Më 18 prill 2016, Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se ajo ka vepruar në pajtim me aktgjykimin kushtetues (shih, Aktgjykimin Rev. nr. 85/2016, të 22 marsit 2016).

31. Gjkata vlerësoi se Gjkata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 85/2016, të 22 marsit 2016, i ka korigjuar shkeljet e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, të cilat janë konstatuar nga Gjkata në vendimin e Gjykatës Supreme CN. nr. 7/13, të 19 tetorit 2013, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit nr. KI10/14, të 20 majit 2014.
32. Gjkata, më tej, shtoi se Gjkata Supreme, më 7 prill 2017, paraqiti në Gjykatë kopjen e fletëdorëzimit, ku thuhet se ajo më 14 janar 2016 i dorëzoi parashtruesit Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI10/14, si dhe kërkesën e palës kundërshtare për kthim në gjendje të mëparshme.
33. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 116 të Kushtetutës, Gjkata vëren se në bazë të dokumenteve të përfshira në kërkesë, Gjkata Supreme ia dorëzoi parashtruesit kopjen e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, të parashtruar nga pala kundërshtare, siç është përcaktuar me dispozitat përkatëse të ligjit procedural; megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk dha asnjë përgjigje ndaj kërkesës së paraqitur nga pala kundërshtare.
34. Rrjedhimisht, Gjkata vëren se Gjkata Supreme me Aktgjykimin [Rev. nr. 85/2016] e ka mënjanuar shkeljen e përmendur procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, dhe kështu e respektoi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI10/14.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

35. Gjkata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
36. Gjkata i referohet nenit 6.1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

“Gjatë përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve të natyrës civile, çdo person ka të drejtë për gjykim të drejtë në [...] gjykatë”.
37. Për sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës, Gjkata vëren se pretendimet ankimore për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën Gjkata Supreme e refuzoi kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme. Gjkata thekson që këto

pretendime të parashtruesit të kërkesës ishin trajtuar tërësisht nga Gjykata Supreme.

38. Në Aktvendimin CN. nr. 6/2016, të 23 gushtit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e paafatshme kërkesa e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme, Gjykata Supreme arsyetoi:

"[...] Gjykata Supreme e Kosovës të paditurës ia dërgon aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe kërkesën (propozimin) për kthimin në gjendjen e mëparshme, të cilën e paditura e pranon më datë 14.01.2016.[...]"

Nga momenti kur propozuesi është vënë në dijeni, fillon të rrjedhë afati subjektiv prej 7 ditëve brenda të cilit e paditura është dashur të paraqesë propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme, ndërsa të njëjtën e ka paraqitur më datë 27.4.2016.

Dispozita e nenit 130 par. 3 të LPK-së, rregullon afatin objektiv - skadimi i kohës së caktuar prej 60 ditësh nga dita e mosveprimit, në këtë rast skadimi i afatit për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme. Në rastin konkret e paditura nuk ka ndërmarrë veprimet procedurale në afatin e paraparë sipas nenit 130 par. 2 e 3 të LPK-së, për cilat arsye Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi. [...]"

39. Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të këtij rasti, të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme ka dhënë arsyetime të detajuara dhe të qarta për vendimin e vet, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme, si të paafatshme.
40. Përveç kësaj, Gjykata rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës është vetëm ta sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; dhe, po ashtu, shih rastin: KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
41. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

42. Gjykata posaçërisht rikujton faktin se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret, përveç se ai është i pakënaqur me rezultatin e procedurës në të cilën është refuzuar kërkesa e tij për kthim në gjendje të mëparshme (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).
43. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk i jep të drejtë të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

Përfundim

44. Duke pasur parasysh atë që u tha, si dhe praktikën konsistente të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës dhe qëndrimet e cekura në këtë vendim, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë që tregon se pretendimet e parashtruesit në kërkesën në fjalë ngrenë çështjet kushtetuese në të cilat është thirrur.
45. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij këto të drejta.
46. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me kriteret e pranueshmërisë në rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

